



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datë / Izlazni: Date / Dana: 20 / 08 / 2024		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 248	Nr. Faqeve. Br. Straha. 2
Ferizaj - Uroševac		

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net  
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

## Procesverbal nga takimit mbi Buxhetimit me Pjesëmarrje në fshatin Komogllavë

Data 17.07.2024

Projekti "Kontrata Sociale" në bashkëpunim me USAID-in ka organizuar një takim të rëndësishëm të buxhetimit për vitin 2024 në Komunën e Ferizajt, ku pjesëmarrja aktive e qytetarëve ka qenë në qendër të vëmendjes. Takimi u mbajt në Shkollën Fillore "Besim Rexhepi", duke ofruar një platformë për qytetarët të shprehin mendimet e tyre dhe të ndajnë prioritetet për projektet që do të financohen.

Në takim ishin të pranishëm drejtori i infrastrukturës, Meriton Hajdini, zyrtari i lartë i financave Fisnik Sylejmani, dhe një asambleist nga ana e Partisë Demokratike, të cilët treguan angazhimin e tyre për të përfshirë qytetarët në procesin e buxhetimit dhe vendimmarrjes komunale.

Planifikimi i 120 mijë eurove për realizimin e tre projekteve në tre lokalitete të ndryshme të qytetit dëshmon një përkushtim të qartë për zhvillimin lokal dhe për të plotësuar nevojat e komunitetit. Buxhetimi me pjesëmarrje u vlerësua si një metodë demokratike dhe proaktive, duke e lejuar qytetarët të jenë të përfshirë aktivisht dhe të japin kontribut në zgjedhjen e projekteve që do të realizohen.

Gjatë procesit, komuniteti dha ide të ndryshme, me shumicë të pjesëmarrësve të qenë nga gjinia mashkullore, të cilat u listuan në FlipChart.

Disa nga këto ide përfshijnë ndërtimin e një parku lojërash, drunj dekorativ, krijimin e një kabineti të informatikës në Shkollën "Besim Rexhepi", instalimin e tabela digjitale në të njëjtën shkollë, si dhe ndërtimin e 11 pritoreve për autobusë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ky angazhim dhe pjesëmarrje e gjerë e komunitetit tregon një ndërgjegje të lartë sociale dhe një dëshirë të fortë për të përmirësuar infrastrukturën dhe jetën e përditshme në fshatin Komogllavë.

Prej takimeve që kemi pas deri në këtë ditë në fshatin Komogllavë jemi nda shumë të kënaqur edhe me pjesëmarrjen qytetare, por edhe me interesimin e tyre rreth çështjeve të cilat do vazhdojnë për etapën e dytë të takimeve.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli